



Prishtinë, 18.12.2025
Kodi i ZRRE-së: V_3004_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2767_10_25** i datës 08.10.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës.

në seancën e mbajtur më datë 18.12.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **F. O.**, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2767_10_25 i datës 08.10.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 08.10.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2767_10_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit **F. O.**, lidhur me kontestimin e faturës së muajit 01/2025 si dhe kontestimin e komponentëve të tarifave si konsumi i përbashkët dhe kapaciteti termik.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori **F. O.**, brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Nuk është dhënë asnjë arsyetim ose analizë profesionale që sqarojnë faktorët që kanë ndikuar në rritjen e shumës së faturës së muajit 01/2025, në raport me periudhat paraprake;
- Nuk është trajtuar fare cilësia e shërbimit të ngrohjes, dhe nuk është ndërmarrë asnjë verifikim në terren për ta konstatuar gjendjen faktike;
- Faturimi duhet të bëhet vetëm për hapësirat e banimit që realisht ngrohen dhe jo për hapësira të tjera.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2025 i ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Vendimi i DMK-së i dt. 08.10.2025, Ankesa e konsumatorit, Ankesa adresuar DMK-së e dt. 10.04.2025; Faturat e konsumatorit, dhe Kartelën e konsumatorit me shifër 013892, të dhënat e leximit dhe faturimit për konsumatorin; si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit është e pabazuar, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, vihet re që, konsumatori për muajt 10-12/2024 është faturuar me sipërfaqe ngrohëse ose C33, ndërkaq, duke filluar nga muaji 01/2025 e deri në përfundimin e sezonës ngrohëse, është faturuar me matje. Faturat me matje, përgjatë këtyre muajve, janë si në vijim: muaji 01/2025 = **94.68 €**, muaji 02/2025 = **67.69 €**, muaji 03/2025 është **22.22 €**. Ndërlidhur me faturën të cilën e ka kontestuar konsumatori, DMK fillimisht e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivlerësim tek NQ Termokos dhe prej tyre, DMK me dt. 18.07.2025. është njoftuar si në vijim: **“për muajt për të cilët konsumatori është faturuar me C11 (me matje) nuk shohim ndonjë gabim në kalkulim”**.

Lidhur me moskthimin e Përgjigjes konsumatorit, Bordi thekson se, nga DMK, me të drejtë është konstatuar se - ndërmarrja NQ Termokos ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 – Mbrojtja e Konsumatorëve, të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, si në vijim: *“Çdo furnizues është përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve të vet, duke bërë adresimin e ankesave në lidhje me çdo veprim, mospërfillje ose shkelje të bëra nga vet furnizuesi apo operatori i sistemit, si dhe duke bërë përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur këto ankesa”, si dhe me nenin 9 – Procesi i shqyrtimit të ankesave, në të cilin përcaktohet si në vijim: “Furnizuesi do ta shqyrtojë dhe do t’i përgjigjet çdo ankese të konsumatorit sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të drejtë dhe në kohë të arsyeshme. 2. Kurdo që mund të ketë bazë për të besuar se ankesa/kontesti mund të zgjidhet në mënyrë joformale dhe me marrëveshje dypalëshe, parashtruesi i ankesës ose furnizuesi në fjalë mund të ftojë palën tjetër për të negociuar në përputhje me kreun V të kësaj rregulle. 3. Afati për shqyrtimin e ankesës nga ana e furnizuesit do të jetë tridhjetë (30) ditë kalendarike, mirëpo nuk do të tejkaloj afatin përfundimtar prej tre (3) muaj nga data e pranimit dhe regjistrimit të ankesës për raste më të ndërlikuara”*.

Por që, pavarësisht mos shqyrtimit të ankesës së konsumatorit me kohë, dhe moskthimit të Përgjigjes, Bordi ka gjetur se, fatura e kontestuar e muajit 01/2025 në vlerë prej 94.68 € është e saktë, dhe se e njëjta pasqyron shpenzimet e krijuara nga konsumatori për këtë muaj, ashtu që, nuk ka elemente të korigjimit financiar për këtë faturë. Bordi i ka analizuar me kujdes edhe të dhënat lidhur me impulset e gjeneruara nga matësit/alokatorët e vendosur në banesën e konsumatorit, dhe ka gjetur se, si të tilla janë të sakta, ashtu që, për pesë (5) radiatorët, është evidentuar më saktësi se sa impulse janë regjistruar në sistemin matës, rrjedhimisht, sa energji termike është shpenzuar nga konsumatori. Pra, nga këto dokumente, vihet re, **për muajin 01/2025, në sistemin matës të konsumatorit, janë regjistruar 2,092 impulse, dhe se konsumatori është faturuar sipas gjendjeve të regjistruara në sistemin matës**. Në këtë kuptim, faturat është e saktë dhe reflekton shpenzimin real të konsumatorit.



Nuk qëndrojnë pretendimet për rritje të faturës për rreth 98.37%, ngase sa mund të shihet, edhe fatura e konsumatorit për muajin 02/2025 është në shumën prej 67.69 €.

Ndërlidhur me kontestimin e komponentëve të tarifave – konsumi i përbashkët dhe kapaciteti termik, Bordi iu njofton se, konsumi i përbashkët i energjisë termike, paraqet sasinë e energjisë termike të pamatur nga matësit individualë të nxehtësisë, por përfshihet në faturë. Shpërndarja e konsumit të përbashkët, llogaritet dhe faturohet bazuar në pjesëmarrjen e sipërfaqes ngrohëse të njësisë së banimit, gjegjësisht të lokalit afarist, ndaj totalit të sipërfaqes së ndërtesës kolektive. Konsumi i përbashkët, përbën 20% të konsumit të energjisë termike në ndërtesë kolektive. Konsumi i përbashkët u faturohet të gjitha njësive banesore – me matës dhe pa matës – dhe vlera ndryshon çdo muaj, varësisht nga konsumi total i energjisë termike.

Më tej, janë analizuar edhe të dhënat lidhur me nënstacionin 394 – UL, nga i cili furnizohen me energji termike të gjithë banorët e objektit në fjalë dhe ka gjetur se, konsumi i përbashkët si komponentë e tarifave të energjisë termike, u është shpërndarë të gjithë konsumatorëve në mënyrë proporcionale dhe në harmoni me metodologjinë e përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Nga sa më sipër, edhe në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike me nr. 01/2022, gjegjësisht neni 16 – Struktura Tarifore dhe Faturimi, si në vijim: *“Për konsumatorët me matje (siç është përcaktuar në paragrafin 5 të Nenit 15) tarifat duhet të jenë si në vijim: a) Komponenti fiks i tarifës: ngarkesa (pagesa) mujore e kapacitetit bazuar në kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes [€/kW për muaj]; b) Komponenti variabil i tarifës: ngarkesa mujore e energjisë bazuar në furnizimin e matur me ngrohje [€/MWh apo €cent/kWh]; c) Nëse më shumë se një konsumator është i kyçur në një nënstacion (‘ndërtesat me shumë njësi’), atëherë konsumi i matur në këtë nënstacion do të shërbej si matje bazë për faturim, ndërsa alokimi tek konsumatorët bëhet si në vijim: c.1) në rastet kur në ‘ndërtesat me shumë njësi’ ekzistojnë pajisjet matëse në nivel njësie, alokimi bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në shtojcën ‘8’; dhe 16 c.2) në rastet kur në ‘ndërtesat me shumë njësi’ nuk ekzistojnë pajisjet matëse në nivel njësie, alokimi i konsumit të matur në nivel nënstacioni duhet të alokohet tek secili konsumator i kyçur proporcionalisht me sipërfaqen ngrohëse [m²]”, është i përcaktuar komponenti i konsumit të përbashkët, dhe rrjedhimisht, pretendimi i konsumatorit, që kjo komponentë nuk përfshihet në tarifa, është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar.*

Më tej, edhe duke iu referuar Shtojcës 8 – të Metodologjisë së Alokimit të Kostos së ngrohjes në ndërtesat me shumë njësi kolektive, tek Parimet Kryesore është përcaktuar si vijon: *“Fatura e ngrohjes e konsumatorëve që banojnë në ndërtesat kolektive do të përbëhet nga: i) komponentët fiks: që merr parasysh kapacitetin termik të konsumatorit dhe konsumin e përbashkët të energjisë termike (ngrohjes) të ndërtesës, dhe do t’u tarifohen konsumatorëve pavarësisht nga sasia e ngrohjes së konsumuar; dhe ii) komponenti variabël që do të llogaritet në bazë të sasisë së matur të ngrohjes së konsumuar.*

Tutje, pika d) e Bilancit të Konsumit të Energjisë Termike (ngrohjes) së një ndërtese me shumë njësi (kolektive), parashihet si në vijim: *“Në ndërtesën me shumë njësi, krahas konsumit të ngrohjes së njësive, është prezent edhe ‘konsumimi i përbashkët’, në formën e: i) transmetimit të nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër hapësirat e përbashkëta të ndërtesave (korridoret, shkallët etj.); ii) transmetimi i nxehtësisë nga tubat që kalojnë nëpër njësi (në rastin e përdorimit të HCA-ve të*



montuar në radiatorë); dhe iii) transmetimin e nxehtësisë ndërmjet mureve dhe tavaneve të njërive ngjitur”.

Duke u bazuar në nenin 28 – Faturimi, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si në vijim: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”*, Bordi thekson se, NQ Termokos, ka vepruar në harmoni me kërkesat ligjore që burojnë nga legjislacioni sekondar.

Duke u bazuar në nenin 6 – Furnizimi me Energji termike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë termike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë termike të cilën e ka shpenzuar. Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- NQ Termokos;
- Konsumatorit F.O., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.